

V E N D I M
Nr.544, datë 1.8.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 624, DATË 21.12.1999 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË PALËS
SHQIPTARE, PJESEMARRËSE NË FORCËN SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS
JUGLINDORE DHE TË DREJTAT E USHTARAKËVE AKTIVË, PJESEMARRËS NË KËTË
FORCË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.8544, datë 4.11.1999 “Për ratifikimin e marrëveshjes dhe protokollit shtesë “Për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore”” dhe të neneve 124 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pjesën II të vendimit nr.624, datë 21.12.1999 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 shprehja “... me vendndodhje në Plovdiv, Bullgari ...”, zëvendësohet me “... në vendndodhjen e shtabit të brigadës...”.
2. Në pikën 11 shprehja “... për këtë shtet, Bullgarinë, ...” zëvendësohet me “... për shtetin ku është vendosur shtabi i brigadës ...”.
3. Në pikën 12 pas fjalës “... gaz ...” shtohen fjalët “... lavanderi dhe abonim në kabëll TV...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano